



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Fakulteti Ekonomik, shpall konkurs për personel ndihmësakademik me kohë të plotë, sekretar mësimor.

Personeli ndihmësakademik, *sekretar mësimor*, është pjesë e sekretarisë mësimore të Fakultetit Ekonomik. Sekretari mësimor, ka përgjegjësi për hedhjen, administrimin arkivimin dhe ruajtjen e të dhënave mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor, veçanërisht ka përgjegjësi për plotësimin e regjistrimit bazë të studentëve.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:

Kritere të përgjithshme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (të paktën Master profesional) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë.
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune.
- Të jetë njohës i një gjuhe të huaj perëndimore.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

Kritere të veçanta:

- Të ketë aftësi të mira në përdorimin e kompjuterit dhe programeve kompjuterike bazë (Ms. Office).
- Të ketë përvojë pune jo më pak se një vit në pozicione pune në marrëdhënie me të tretë.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**30.10.2023 – 08.11.2023**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës *sekretar mësimor* në Fakultetin e Ekonomik
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Referenca pune nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (30.10.2023 – 08.11.2023) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: sekretar mësimor në FE
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit Ekonomik**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë brenda periudhës (10.11.2023 – 24.11.2023). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës si dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.